



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI I BASHKISË

PROJEKT - VENDIM

Nr. Datë / 12 /2025

“PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË KOLONJË DHE NDËRMARRJEVE TË VARËSISË SI DHE NIVELIN E PAGAVE PËR VITIN 2026”

Në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligji Nr. 44/2015 “ Kodi i Proceduarave Administrative” i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, Ligjit Nr.68/2017, datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” Vendimi Nr.503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Vendimi Nr.419 datë 26.06.2024 “ Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pages bruto mujore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, Vendimi Nr. 421 datë 26.06.2024 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 325 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministarve për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zvendësministrave të funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënrefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar, Vendim Nr.425 datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar” Ligjit Nr. 35/2023 “Për kompetencat dhe caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pages bazë minimale në shkallë vendi”

PROPOZOJMË:

1. Të miratohet numri i përgjithshëm i punonjësve të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 i cili do të jetë 300 (treqind)
2. Të miratohet niveli i pagave për punonjësit e zgjedhur ose të emëruar në bashkinë Kolonjë, në institucionet dhe ndërrmarjet e varësisë.
3. Ky Projekt – Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr. 139/2015 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

KRYETARI
ERION ISAI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

Nr. 9139 Prot.

Ersekë më 12 . 12.2025

RELACION
PËR

PROJEKT-VENDIMIN

Nr. ___ Datë _____

**“PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË
BASHKISË KOLONJË DHE NDËRMARRJEVE TË VARËSISË SI DHE NIVELIN E
PAGAVE PËR VITIN 2026”**

Projekt – Vendimi që po ju paraqesim bazohet në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligji Nr. 44/2015 “ Kodi i Proceduarave Administrative” i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, Ligji Nr.68/2017, datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil” Vendimi Nr.503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Vendimi Nr.419 datë 26.06.2024 “ Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pages bruto mujore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, Vendimi Nr. 421 datë 26.06.2024 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 325 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zvendësministrave të funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënrefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administrates publike” të ndryshuar, Vendim Nr.425 datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar” Neni 6 pika c) i Ligjit Nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administrates publike, si dhe të pages bazë minimale në shkallë vendi”

Te nderuar,

Për të garantuar shërbim cilësor dhe të qëndrueshëm për qytetarët e Bashkisë Kolonjë është i domosdoshëm një staf prej 300 (treqind) punonjësish. Ky numër përfshin:

1. Kabinetin.
2. Auditi i Brendshëm.
3. Sektori i Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit.
4. Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike. (2 sektorë)
5. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.(4 sektorë)
6. Drejtoria Ekonomike, Financës dhe Buxhetit. (2 sektorë)
7. Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim- Taksave. (2 sektorë)
8. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. (2 sektorë)
9. Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit. (3 sektorë)
10. Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Mjedisit. (2 sektorë)
11. Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve. (9 sektorë)
12. Drejtoria e Arsimit. (2 sektorë)
13. Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit. (4 sektorë)
14. Drejtoria e Turizmit dhe Agroturizmit. (3 sektorë)
15. Drejtoria e Shërbimeve Publike. (5 sektorë)
16. Policia Bashkiake.
17. MNZSH.
18. Drejtoria e Mbrojtjes Civile.

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e Bashkisë Kolonjë do të mbulohen nga buxheti i vitit 2026 nga të ardhurat e veta të bashkisë dhe nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme.

Niveli i pagës për funksionarët dhe nëpunësit civilë në Bashkinë Kolonjë.

Nr.	EMËRTIMI	Klasa	Kategori	Paga për Pozicion	Grupi I Diplomës
1	Kryetar	-	-	240,000	-
2	Nënkryetar	-	-	185,000	-
3	Këshilltar	III	III-2	105,000	
4	Sekretar i Përgjithshëm	I	I-5	170,000	1
5	Drejtor i Përgjithshëm	I	I-5	151,000	1
6	Sekretar Këshilli	II	II-2	141,000	1
7	Drejtor Drejtorie	II	II-2	141,000	1
8	Përgjegjës Sektori / Kryeinspektor	III	III-2	105,000	1
9	Përgjegjës Sektori	III	III-3	98,000	1
10	Specialist / Inspektor	IV	IV- 3	70,000	1,2,3
11	Specialist	IV	IV- 4	60,000	1,2,3
12	Sekretar i kryetarit	IV	IV- 4	60,000	1,2,3
13	Administrator	-	-	140,000	-

Niveli i pagave për punonjësit mësimorë në Bashkinë Kolonjë.

Nr.	Emërtimi	Paga e Pozicionit	Grupi I Diplomës
1	Drejtor i Kopshtit me Ushqim	80,000	1
2	Drejtor i Kopshtit pa Ushqim	75,000	1
3	Përgjegjës Sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve.	73,000	1
4	Instruktor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve.	60,000	1
5	Edukator Konvikti / Kujdestar Konvikti	58,000	1,2,3,4
6	Edukator në kopsht fëmijësh	58,000	1,2,3,4

Nivëli i pagës për punonjësit e MNZSH.

Nr.	Emërtimi	Paga bazë për Gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune	Shtësa për Vjetërsi
1	Asistent Zjarrfikës	60,000	7,000	1%
2	Zjarrfikës	65,000	8,000	1%
3	Kryezjarrfikës	70,000	8,000	1%
4	Inspektor Zjarrfikës	75,000	6,000	1%
5	Kryeinspektor Zjarrfikës	85,000	6,000	1%

Niveli i pagës për punonjësit e Gjendjes Civile.

Nr.	Emërtimi	Paga Bazë	Kategori
1	Përgjegjëse e Gj.Civile	98,000	III-3
2	Përgjegjëse e Gj.Civile	90,000	IV-1
3	Përgjegjëse e Gj.Civile	90,000	IV-1
4	Përgjegjëse e Gj.Civile	90,000	IV-1

Në bazë të Nenit 54, pika ç) e Ligjit Nr.139/2025 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” , Neni 6 pika c) e Ligjit Nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administrates publike, si dhe të pages bazë minimale në shkallë vendi” Këshilli Bashkiak ka miratuar ndryshimin e nivelit të pagave për punonjësit mbështetës dhe punonjësit e policisë bashkiake në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Niveli i pagës për Punonjësit Mbështetës.

Nr.	Emërtimi	Paga për klasë	Shtësa për Vjetërsi
1	Sanitar, punonjës shërbimi, korrier, lulishtar.	50,000	1%
2	Rojë kaldaist, ndihmës kuzhinier.	51,000	1%
3	Punonjës mirëmbajtje të profesioneve të ndryshme, ,shofer autoveture, shofer automjeti transporti deri 2.5 ton.	51,800	1%
4	Magaznier.	52,500	1%
5	Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme, teknik ndërtimi , fotograf, kuzhinier.	52,800	1%
6	Punonjës Sekretarie.	53,200	1%
7	Biblotekar, Shofer transporti me automjet mbi 2.5 ton.	53,600	1%
8	Sekretar shkolle në shkollat e arsimit të mesëm të lartë , kryekuzhinier, arkivist, llogaritar /ekonomist, Shofer automjeti transporti mbi 2.5 ton dhe mjeteve special.	54,100	1%
9	Shofer me automjete speciale	54,800	1%
10	S'ka	55,300	1%
11	S'ka	55,700	1%
12	S'ka	56,000	1%
13	Manovrator i makinerive të rënda	56,700	1%

Niveli i pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake

Nr.	Emërtimi	Bëhet	Shtësa për Vjetërsi
1	Inspektor i Policisë Bashkiake	66,000	1%
2	Oficer Terreni	62,000	1%

Niveli i pagesës të punonjësve të Bashkisë Kolonjë sipas tabelës bashkëngjitur, të cilët janë të punësuar me Kod Pune, por që kanë kualifikime të larta arsimore dhe për të cilët pagesa duhet të reflektojë nivelin e arsimit të tyre.

Niveli i pagës për punonjësit administrativë në Bashkinë Kolonjë.

Emërtimi	Klasa	Grupi	Paga për Pozicion
Përgjegjes në Sektorin e Bordit të Kullimit	III-3	1	98.000
Përgjegjës në Sektorin e Sportit	III-3	1	98.000
Përgjegjës në Sektorin e Rrugëve Rurale	III-3	1	98.000
Përgjegjës në sektorin e Zhvillimit të Komunitetit.	III-3	1	98.000
Inspektor Terreni në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave	IV-4	1 ose 2 ose 3	60.000
Specialist në Sektorin e Bordit të Kullimit	IV-4	1 ose 2 ose 3	60.000
Kontrollor Pune në Sektorin e Zhvillimit të Komunitetit, Punët Publike	IV-4	1 ose 2 ose 3	60.000

Konc: Specialist F.Feka

Konf: Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse i Komanduar D. Tallo

Drejtor i Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit G. Duka

Drejtori i Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike O. Lifa

Miratoi: Sekretari i Përgjithshëm

S. Rexhepi

